



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Datë/a:	27.04.2021
Referenc-ë:	
Për/ Za/ To:	“Plisat”
Përmes/Preko/Through:	Drejtoris së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit.
Nga/ Od/ From:	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësirë publike Kontrolloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën përmes emailit zyrtar nga tifo grupi “Plisat” me të cilën kërkohet që me datë 28 Prill, 9 Maj dhe 23 Maj 2021 të bëhet shfrytëzimi i hapësirës publike në pllato e Pallatit të Rinisë.

Qëllimi i aktivitetit është vendosja e disa altoparlantëve në pllato në mënyrë që të lëshohen audio të këngëve të tifo grupit “Plisat” sepse për shkak të situatës në të cilën jemi është e pamundur ta përkrahin nga afër FC Prishtina pasi që është shumë afër së shpalljes Kampionë në Superligën e Kosovës.

Drejtoria pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike në pllato e Pallatit të Rinisë me datën 28 Prill, 9 Maj dhe 23 Maj 2021 dhe vendosjen e altoparlantëve sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Duhet të pajiseni me pëlqim edhe nga menaxhmenti i Pallatit të Rinisë;
- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.